



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Rregj. Them. 526

Data e rregjistrimit 04.02.2014

Nr. Vendimit 487

Data e vendimit 05.03.2014



VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues te përbërë nga gjyqtaret:

Lindita SINANAJ	Kryesuese
Artur MALAJ	Anëtar
Altina NASUFI	Anetare

me sekretare gjyqesore *Ermelinda Nuraj*, ne Tirane, sot më datë 05.03.2014, mori në shqyrtim në dhome keshillimi çëshjen administrative, që i përket paleve:

PADITËS: Shoqëria "Koha Ekspres" sh.p.k. me perfaqesues ligjor Gezim Kaja dhe seli në lagjen "Skender Libohova" Lushnjë.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

OBJEKTI: Konstatimi i pavlefshmërisë të njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore Nr. 5004 prot. date 17.03.2011, kundërshtimin e tre proces-verbaleve gjobë me Nr. Serie 0002871, 0002874, 0002867 të mbajtur nga inspektorët në sektorin e zbatimit pranë Drejtorisë

Rajonale Tatimore Tiranë, sipas shkresës Nr. 7044
date 03.02.2011

BAZA LIGJORE: Nenet 32/a, 153, 154, 324/b, 331 të K.Pr.Civile. nenet
30/2, 33, 109/2 të ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Për
procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet e parashtruara ne ankim nga pala
e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier qe kerkon:

*-ndryshimin e vendimit Nr. 1887, datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe
lënien në fuqi të njoftim vlerësimit me nr. 5004, date 17.03.2011, si të bazuar në ligj dhe në
prova.*

shqyrtoi pretendimet e parashtruara ne ankim nga Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore
Vlore qe kerkon:

*- ndryshimin e vendimit Nr. 1887, datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier duke
rrezuar teresisht kerkesen*

dhe bisedoi ceshtjen ne teresi:

VËREN

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.02.2014, jane rregjistruar ankimet e
paraqitura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore
Vlore, kundër vendimit Nr. (1887) 62-2011-3763, date 05.12.2011 te Gjykates se Rrethit
Gjyqësor Fier, bazuar ne nenet 442, 443 te K.Pr.Civ. dhe nenin 48 te ligjit Nr. 49/2012
"Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarroeshjeve
administrative". Keto ankime fillimisht jane rregjistruar në Gjykatën e Apelit Vlore, në
datën 07.02.2012. Kjo gjykatë me vendimin e saj Nr. 878, datë 19.12.2013 ka shpallur
moskompetencën e saj për gjykimin e kësaj çështjeje duke dërguar aktet për
kompetencë gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të fillimit të

funksionimit të gjykatave administrative në datën 04.11.2013, si dhe referuar Vendimit Unifikues Nr. 3 datë 06.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 11.07.2011, paditësi i është drejtuar Gjykatës së Prerthit Gjyqësor Fier me padinë objekt i këtij gjykimi. Kjo gjykate pas shqyrtimit të ceshtjes, me vendimin Nr. (1887) 62-2011-3763, date 05.12.2011, ka vendosur: *"Pranimin e kërkesë-padisë. Anullimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 5004 Prot date 17.03.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, lënë në fuqi me vendimin nr. 8790/1 date 29.06.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor."*

Kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankim pala e paditur dhe avokatura e shtetit duke parashtruar të njëjtat pretendime si më poshtë:

- ❖ Ndaj palës paditëse shoqëria "Koha Ekspres" sh.p.k. është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në autobuzët e subjektit i cili transportonte udhëtarë të papajisur me bileta udhëtimi dhe në bazë të ligjit Nr. 9920, date 19.05.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, ndryshuar me ligjin me Nr. 10261, date 01.04.2010, neni 122 pika 3 janë vendosur tre gjoba të ndryshme:
 - Gjoba e parë 30.000 lekë, është vendosur me anë të procesverbalit me nr. Serie 0002881 date 28.01.2011, për mospajisjen e 3 pasagjerëve me biletë udhëtimi.
 - Gjoba e dytë 60.000 lekë, është vendosur po në këtë datë, me procesverbalin nr. serie 0002874, për mospajisjen e 6 pasagjerëve me biletë udhëtimi.
 - Gjoba e tretë 80.000 lekë, e vendosur po në date 28.01.2011, me procesverbalin me nr. serie 0002867 për transportimin e tete pasagjereve pa i pajisur me bilete.
- ❖ Në bazë të këtyre procesverbaleve ka dalë njoftim vlerësimi tatimor me nr. 5004, date 17.03.2011 nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
- ❖ Nga ana e subjektit ky njoftim është apeluar në Drejtorinë e Apelit Tatimor, e cila me vendimin Nr. 8190/1, date 29.06.2011, ka lënë në fuqi njoftim vlerësimin tatimor me Nr. 5004, të date 17.03.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
- ❖ Referuar fakteve të mësipërme subjektit në fjalë i është vendosur masa e gjobës për moslëshimin e biletave të udhëtimit për 17 udhëtarë, si dhe është kryer vlerësimi tatimor në lidhje me TVSH-në.

- ❖ Pra, procesverbalet e sipërcituar, të përpiluar nga ana e inspektorëve të zbatimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, në bazë të të cilit ka dalë njoftim vlerësimi me Nr. 5004, date 17.03.2011, nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, është e bazuar në ligjin me Nr. 9920, date 19.05.2010, ndryshuar me ligjin Nr. 10148, date 28.09.2009, ndryshuar me ligjin me Nr. 10209, date 23.12.2009, ndryshuar me ligjin me Nr. 10261, date 01.04.2010, neni 122, pika 3, dhe neni 68, pika 4 dhe 5, si dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave me Nr. 24, date 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me Udhëzimin Nr. 37, date 01.09.2009, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 6, date 19.02.2010, ndryshuar me Udhëzimin me Nr. 13, date 14.04.2010, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 27, date 18.08.2010, ndryshuar me udhëzimin Nr. 32 date 21.09.2010, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 34, date 22.09.2010 pika 122/3, ku citohet se: "Moslëshimi i biletave të shërbimit me vlerë të parashtypur, të përdorura në sektorë të ndryshëm, si transport, turizëm, art, kulturë etj., dënohet me gjobë në masën 10.000 lekë për çdo biletë."
- ❖ Në lidhje me pretendimin e tatimpaguesit për mosndalimin e autobuzëve nga ana e inspektorëve të zbatimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, pala e paditur deklaron se identifikimi i targave të autobuzëve të subjektit është realizuar gjatë kontrollit të tyre, dhe mosidentifikimi i drejtuesve të mjeteve ka ardhur si rrjedhojë e refuzimit të tyre për dhënie të identitetit, duke shkelur kështu edhe ligjin nr. 9920, date 19.05.2010, i ndryshuar, neni 60 "Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike".
- ❖ Gjithashtu, kontrollet janë kryer në mbështetje të ligjit të sipërcituar, neni 80, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave me Nr. 24, date 02.09.2008, i ndryshuar paragrafi 80.3 gërma "c".
- ❖ Pas konstatimit të shkeljes së kryer nga ana e subjektit për mospajisje me biletë udhëtimi nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, është bërë vlerësimi i detyrimit tatimor të TVSH-së bazuar kjo në ligjin me Nr. 9920, date 19.05.2010, i ndryshuar, neni 68, pika 4 dhe 5.
- ❖ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në vendimin e saj me Nr.1887, dt.05.12.2011 nuk ka marre parasysh asnjë nga rrethanat e sipërcituara.

Për sa më sipër pala e paditur dhe avokatura e shtetit kane kërkuar ndryshimin e vendimit Nr. 1887, datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Vleresimi i ceshtjes nga Gjykata Administrative e Apelit

Se pari gjykata vlereson te evidentoje kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit objekt i ketij gjykimi. Ne referim te nenit 7 germa "a", nenit 10 paragrafi 2 germa "a" dhe nenit 44 te ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e kesaj ceshtjeje.

Se dyti gjykata vlereson te marre ne shqyrtim kushtet e pranueshmerise se ankimit. Sikurse eshte referuar edhe me siper ne kete vendim, rezulton qe vendimi te jete shpallur ne daten 05.12.2011, kurse ankimi nga pala e paditur eshte paraqitur ne daten 21.12.2011, pra dukshem brenda afatit pesembedhjte ditor te percaktuar ne nenin 443 paragrafi i pare i K.Pr.Civ. Ankimi nga Avokatura e Shtetit eshte paraqitur ne daten 06.01.2012, per faktin se ka qene ne mungese ne shpalljen e vendimit dhe ka rene ne dijeni te vendimit ne daten 20.12.2013. Rezulton qe ankimi ne fjale te jete derguar nepermjet sherbimit postar ne daten 03.01.2012, pra brenda afatit pesembedhjte ditor nga dita e marrjes dijeni per vendimin. Po keshtu, nuk rezulton te ekzistojne kriteret penguese te parashikuara ne nenin 45 te ligjit Nr. 49/2012 qe e bejne vendimin te paankimueshem. Ankimet rezultojne te jene te plote edhe ne elementet e tjere, si ne elementet e formes edhe te permbajtjes, lidhur me nenshkrimin nga pala qe i ka paraqitur, tregimin e paleve ndergjyqese, vendimin kunder te cilit eshte paraqitur ankimi, apo kerkimet per te cilat jane paraqitur ankimet. Per te gjitha sa me siper gjykata cmon se ankimet e paraqitura kunder vendimit Nr. 1887 date 05.12.2011, objekt gjykimi, duhet te pranohet per shqyrtim.

Parashtrimi i rrethanave te faktit

Paditësi, shoqëria "Koha Ekspres" sh.p.k. është rregjistruar si person juridik në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe me objekt te aktivitetit te saj "Transportimin e udhëtarëve, bagazheve të tyre, parking automjesh, servis, lavazh, transport mallrash e

pasagjereshi brenda dhe jashte vendit, import eksport me shumice e pakice, tregetim mallrash industriale, ushqimore, bujqesore, blegtorale, elektroshtepiake, makineri, prodhim e tregetim materiale ndertimi, hapje dyqane, bar-bufe, motele, hotele restorante, agjensi turistike dhe agjensi imobiliare per shitblerje, etj.”, me seli në lagjen “Skënder Libohova” Lushnë.

Në datën 28.01.2011, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me procesverbalin me nr. serie 0002871 është dënuar tatimpaguesi “Koha Ekspres” sh.p.k. me gjobë në shumën 30.000 lekë; me procesverbalin me nr. serie 0002874 me gjobë në shumën 60.000 lekë dhe me procesverbalin me nr. serie 0002867 me gjobë në shumën 80.000 lekë, pasi ishin gjetur shtetas të papajisur me bileta. Bazuar në këto akte Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka nxjerrë Njoftim Vlerësimin Tatimor Nr. 5004, date 17.03.2011, sipas të cilit paditësi ka të papaguara detyrimet tatimore, kamatvonesat dhe gjoba në vlerën 181.420 lekë.

Kundër Njoftim Vlerësimit Tatimor të mësipërm, paditësi ka paraqitur ankim pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, e cila pas shqyrtimit të ankimit administrativ, me vendimin Nr. 8790/1, date 29.06.2011 ka vendosur: “Lënien në fuqi të aktit administrativ njoftim vlerësimit për detyrimet tatimore Nr. 5004, date 17.03.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, për gjobën e vendosur për moslëshimin e biletave, në shumën 170.000 lekë për periudhën 2011/1. Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr. 5004 prot. datë 17.03.2011 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier për detyrimin për TVSH-në për periudhën 2011/1 në shumën 708 lekë, kamatvonesës në shumën 4 lekë dhe gjobës në lidhje me këtë detyrim në shumën 10.708 lekë.”

Pala paditëse pasi ka ezauruar rrugën e ankimit administrativ, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesë padinë objekt gjykimi duke pretenduar se procesverbalet e gjobes janë fiktive, te mbajtur ne menyre te njeanshme. Ne autobuzet e cituar ne keto proceverbale nuk jane kryer kontrole, ne procesverbale nuk gjenden te identifikuar emrat e shofereve dhe numri total i pasagjereve qe ndodheshin ne secilin autobuz.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me kerkimet objekt padie, ka argumentuar se në nenin 9 të Kodit të Procedurës Administrative është sanksionuar parimi i ligjshmërisë, kurse në nenin 10 është sanksionuar parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë. Në nenin 33 të ligjit nr. 9920, date 19.05.2008, i ndryshuar përcaktohet se: *Tatimpaguesi ka të drejtë t'i sigurohen kontrole të arsyeshme, të cilat kryhen në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve, sipas dispozitave të këtij ligji*". Në nenin 81 të ligjit të sipërcituar përcaktohet se: *"Njoftimi i kontrollit tatimor përmban:*

- a) *Identifikimin e organit, që kryen kontrollin tatimor ;*
- b) *Emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, person fizik, ose emrin e personit juridik, subjekt kontrolli;*
- c) *Numrin e identifikimit të tatimpaguesit;*
- d) *Datën e lëshimit*
- e) *Bazën ligjore për kontrollin*
- f) *Llojet e tatimit, objekt të kontrollit*
- g) *Periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor*
- h) *një përshkrim të të drejtave dhe të detyrave të tatimpaguesit gjatë kontrollit tatimor, përfshirë të drejtën e ankimit të vlerësimit, që bëhet ne bazë të kontrollit tatimor*
- i) *datën dhe orën kur fillon kontrolli tatimor;*
- j) *vendin e kontrollit tatimor;*
- k) *nënshkrimin e titullarit të zyrës;*
- l) *një kërkesë për vënien në dispozicion të administratës tatimore të informacionit specifik për kontrollin tatimor."*

Në analizë të dispozitave të sipërcituara si dhe të provave të paraqitura në gjykim, gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzionin se në të tre procesverbalet e mbajtura nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nga ana e inspektorëve nuk është përcaktuar ora e kontrollit, nuk është identifikuar personi përfaqësues i shoqërisë, si dhe identiteti i udhëtarëve të papajisur me bileta. Më tej, nga ana e inspektorëve në rubrikën ku vendoset firma e tatimpaguesit, është shënuar *shoferi refuzon* pa e identifikuar këtë të fundit. Në funksion të realizimit të detyrimeve të tyre ligjore,

inspektorët tatimor duhet të kishin kryer verifikimet e nevojshme në terren dhe t'i kishin pasqyruar në procesverbal.

Parimi i ligjshmërisë i sanksionuar në nenin 9 të K.Pr.A kërkon që organet e administratës gjatë veprimtarisë së tyre jo vetëm që nuk duhet të shkelin ligjin por edhe që aktet që nxjerrin të jenë të autorizuar nga ligji dhe që përmbajtja e tyre të jetë në përputhje me ligjin. Ndërsa parimi i sanksionuar në nenin 10 të këtij kodi siguron një balancim të drejtë midis interesave publike dhe atyre private duke qënë të dyja të ligjshme.

Në këto kushte gjykata e shkallës së parë me të drejte ka vlerësuar se në këtë rast nga ana e inspektorëve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nuk është respektuar parimi i mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë, si dhe parimi i ligjshmërisë, e parë kjo në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, qëllimi i të cilit është mbrojtja reciproke e interesave financiare dhe publike të tatimpaguesve. Për rrjedhojë njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 5004 prot. datë 17.03.2011, i nxjerrë nga ana Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, rezulton të jetë nxjerrë në kundërshtim me ligjin, pasi është mbështetur në procesverbalet e gjobës, të cilët janë mbajtur në kundërshtim me kërkesat e ligjit.

Lidhur me pretendimet e parashtruara në ankim, referuar fakteve të mesiperme, kjo gjykate vlerëson se janë të pabazuara në ligj e prova. Në pretendimet e parashtruara në ankim përfaqësuesi i palës së paditur dhe i avokatures së shtetit nuk japin asnjë argument të kundërt lidhur me sa ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë, por janë mjaftuar vetëm me parashtrimin e pretendimeve të paraqitura edhe në gjykimin në shkallë të parë, pretendime këto që vlerësohen si të pabazuara.

Konstatohet se vendimi i gjykates së shkallës së parë pasqyron një analizë të hollesishme të gjithë pretendimeve të parashtruara nga palët si për sa i përket rrethanave të faktit edhe çështjeve të ligjit. Në konkluzion të kësaj analize, me të drejte gjykata ka vlerësuar se marrja e masës administrative, denim me gjobe në rrethanat

konkrete të cështjes është e pabazuar në ligj dhe përben tejkalim dhe abuzim me të drejtën që i jep ligji organit tatimor.

Për të gjitha sa më sipër kjo gjykatë vlerëson tërësisht të pabazuara pretendimet e parashtruara në ankim nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Fier dhe Avokatura e Shtetit, dhe duke qenë se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në analizë të plote e të hollësishme të rrethanave të faktit e të ligjit, referuar nenit 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 49 e 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI


Lenien në fuqi të vendimit Nr. 62-2011-3763 (1887), datë 05.12.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Tiranë më 05.03.2014.

Anetare
Altina NASUFI

Anetar
Artur MALAJ

Sekretare
Ermelinda NURAJ



PULLE TARIFË

